
**RAPORT PËR VEPRIMTARINË FINANCIARE DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË
BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2016**

Hyrje

Në menaxhimin e financave vendore, Bashkia Korçë ka ndjekur parimet e përcaktuara në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor janë:

- a) transparenca, parashikueshmëria, gjithëpërfshirja, uniteti dhe universaliteti në menaxhimin e sistemit buxhetor e të fondeve speciale;
- b) disiplina fiskale, në përputhje me stabilitetin makroekonomik dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social;
- c) shpërndarja e burimeve, në përputhje me objektivat strategjike të Këshillit të Ministrave;
- ç) përdorimi ekonomik, eficient dhe efektiv i burimeve publike;

Buxheti i Bashkisë është miratuar me VKB nr. 18 datë 17.03.2016 “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë, NJA, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Reja për vitin 2016”. Gjatë vitit 2016 ky buxhet është realizuar në zbatim të ligjeve, VKM, udhëzimeve, urdhërave të Kryetarit të Bashkisë, VKB si dhe akteve ligjore dhe nënligjore.

Për vitin 2016 Bashkia Korçë ka realizuar veprimtarinë e saj financiare duke u bazuar në të ardhurat nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga të ardhurat e trashëguara të vitit 2015, nga fondet e transferuara nga buxheti i shtetit, fondet që ju vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione si dhe burime të tjera të parashikuara me ligj.

-Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

Për vitin 2016 të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore u planifikuan në vlerën 645,371 mijë lekë dhe realizimi ka qënë në vlerën 543,139 mijë lekë ose në masën 84.2%.

Realizimi i këtyre të ardhurave do të jepet në material.

- Të ardhurat nga Institucionet e Varësisë

Të ardhurat nga institucionet e varësisë janë planifikuar në vlerën 22,999 mijë lekë. Realizimi ka qënë në vlerën 16,046 mijë lekë ose në masën 69.8%.

- Të ardhurat nga sponsorizimet

Gjithashtu gjatë vitit 2016 ka patur dhe një sponsorizim 229 mijë lekë për Qendrën e Artit dhe Kulturës.

-Të ardhurat e trashëguara

Për vitin 2016 të ardhurat e trashëguara kanë qënë në vlerën 112,013 mijë lekë

-Transferta e pakushtëzuar

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2016 ka qënë 324,808 mijë lekë.

-Transfertat specifike

Për vitin 2016 transfertat specifike kanë qënë në vlerën 263,855 mijë lekë. Detajimi dhe përdorimi i këtyre transfertave do të jepet në material.

-Fondi i Zhvillimit të Rajoneve 2015-2016 + Buxheti i Shtetit

Për periudhën 2015-2016 fondi nga FZHR dhe Buxheti i Shtetit ka qënë 1,562,825 mijë lekë nga të cilat 240,640 mijë lekë janë nga të ardhurat e trashëguara nga vitit 2015 dhe 1,322,185 mijë lekë janë nga të ardhurat e vitit 2016.

Më poshtë po japim burimet e financimit dhe % për çdo zë ndaj totalit:

Burimet e financimit	Vlera në 000/lekë	% për çdo zë ndaj totalit
-Të ardhurat e trashëguara	112,013	4%
-Transferta e pakushtëzuar	324,808	12%
-Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	543,139	19%
-Të ardhurat e institucioneve të varësisë	16,046	1%
-Sponsorizime të ndryshme	229	0%
-Fondi i Zhvillimit të Rajoneve + Buxheti i Shtetit	1,562,825	55%
-Transferta specifike	263,855	9%
Total	2,822,915	100%

Shpenzimet e realizuara për vitin 2016 jepen si më poshtë:


Shpenzimet	Vlera /000lekë	% për çdo zë ndaj totalit
-Shpenzime personeli(paga+sigurime shoqërore)	486,033	29%
-Shpenzimet operative dhe shërbime publike	406,163	24%
-Shpenzime (principali & interesi)	53,043	3%
-Subvencione	7,000	1%
-Transferta tek organizata të ndryshme	39,117	2%
-Transferta tek individët	3,860	0%
-Shpenzime kapitale	697,393	41%
Total	1,692,609	100%

Transferta e pakushtëzuar

Për vitin 2016 transfera e pakushtëzuar ka qënë në vlerën 324,808 mijë lekë.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Transferta e pakushtëzuar	171,127	167,287	150,337	198,249	230,960	287,925	324,808
Total	171,127	167,287	150,337	198,249	230,960	287,925	324,808

Paraqitja grafike



Sipas nenit 15, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Bashkitë duhet të përdorin jo më pak se 40% të transfertës së pakushtëzuar për investime publike. Bashkia Korçë ka përdorur jo më pak se 40% të transfertës së pakushtëzuar për investime publike dhe i detajuar në tremujorin e parë 30%, në të dytin 25%, në të tretin 23% dhe në të katërtin 22%.

REALIZIMI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË

Në tabelën e mëposhtme jepet realizimi i të ardhurave të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2016.

Emertimi	Bashkia	5% pullat	NSHP	KI Shmsport	Q Artit dhe Kultures	NSHMAC	Sht e foshnjes	KI futb	NJMBS	Qendra ditore	MNZSH	Pyjet	Qendra rezid	Total
Të Ardhurat	531,428,882.52	472,734.00	4,253,379.50	140,000.00	1,336,824.00	10,734,784.20	80,600.00	16,251.00	10,269,253.00	1,000.00	1,259,000.00	11,632,749.00	1,761,300.00	573,386,757.22
D ne buxhet	-822,531.02		-2,400.00	42,000.00			42,420.00	16,251.00		-100.00	377,700.00		1,758,300.00	-3,061,702.02
5% ngurtësim	-1,301,797.00													-1,301,797.00
sponsorizimi					229,499.00									-229,499.00
Bashkia	186,862.50		186,862.50											0.00
pullat 95% per DRT	-9,135,866.00													-9,135,866.00
Vl e mb e te Ardhurave	520,355,551.00	472,734.00	4,064,117.00	98,000.00	1,107,325.00	10,734,784.20	38,180.00	0.00	10,269,253.00	900.00	881,300.00	11,632,749.00	3,000.00	559,657,893.20
Celja Jan-dhjetor	496,799,985.11		3,966,301.00	98,000.00	1,103,525.00	9,782,209.40	38,180.00		7,510,095.00	900.00		9,305,891.00		528,605,086.51
Te ardh te pashpernd ara	23,555,565.89	472,734.00	97,816.00	0.00	3,800.00	952,574.80	0.00	0.00	2,759,158.00	0.00	881,300.00	2,326,858.00	3,000.00	31,052,806.69

Pra siç shihet dhe nga tabela në total të ardhurat janë realizuar në vlerën 559,658 mijë lekë, nga të cilat 473 mijë lekë janë të ardhura nga pullat dhe 528,605 mijë lekë janë çelur për realizimin e shpenzimeve të vitit 2016 dhe vlera prej 30,580 mijë lekë janë të ardhura të papërdorura nga viti 2016, të cilat do të përdoren gjatë vitit 2017.

Totali i të ardhurave të trashëguara të vitit 2016 sipas burimeve të financimit dhe sipas institucioneve është në vlerën 362,648,014.8 lekë. Këto të ardhura do të jenë pjesë e buxhetit të vitit 2017 dhe përdorimi i tyre është paraqitur në materialin e përdorimit të të ardhurave të trashëguara në buxhetin e vitit 2017. Këto të ardhura jepen në tabelën e mëposhtme:

Institucionet	Mbartur nga grand shpenzimet 01	Mbartur nga te ardh shpenzimet 05	Mbartur nga shpenzimet tr specifike	Mbartur nga shpenzimet FZHR	Mbartur nga të ardhurat 05	Mbartur nga të ardhurat tr sp	Mbartur nga sp(ardh)	Mbartur nga sp(shp)	Të ardh të trash viti 2016
Arsimi parashkollor	100.00	513,056.35			892,210.00				1,405,366.35
Arsimi parashkollor tr specifike			2,990,379.00						2,990,379.00
Arsimi parauniversitar					47,800.00				47,800.00
Arsimi parauniversitar tr sp			21,220.00						21,220.00
Konviktet e arsimit paraunivesitar		122,444.40			12,564.00				135,008.40
Klubi shumesportesh		59,774.00							59,774.00
Klubi i futbollit	159,882.00	468,994.00							628,876.00
Qendra e Artit dhe kultures	378,619.12	379,986.00			3,800.00			17,983.00	780,388.12

NJMBQS		351,701.00							351,701.00
Nshp		249,550.20			97,816.00				347,366.20
Nshp fondi tranzitor	15,773.00								15,773.00
Bordi I kullimit			8,338,616.00						8,338,616.00
Rruget rurale			295,418.00						295,418.00
Bashkia	62,284,498.97	25,163,135.55		222,179,460.00	23,555,566.69	4,016,002.52	472,734.00	1,068.00	337,672,465.73
Bashkia Apartamentet me qera					2,759,158.00				2,759,158.00
Mbrojtja nga zjarri			1,123,517.00		881,300.00				2,004,817.00
Administrimi I pyjeve			957,154.00		2,326,858.00				3,284,012.00
Huaja bankare	1,262,968.00	11,767.00							1,274,735.00
Qendra rezidenciale		4,655.00			3,000.00				7,655.00
Qendra ditore		8,960.00							8,960.00
Shtepia e foshnjes	2,142.00	138,403.00						77,981.00	218,526.00
Totali	64,103,983.09	27,472,426.50	13,726,304.00	222,179,460.00	30,580,072.69	4,016,002.52	472,734.00	97,032.00	362,648,014.80

I. REALIZIMI I TË ARDHURAVE NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE PËR VITIN 2016


TAKSA MBI NDËRTESEN

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
1	Taksa mbi ndërtesën	124 000 000	120 053 537	97 %

Taksa mbi ndërtesën për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 124 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 97% ose në vlerë 120 053 537 lekë. Kjo shumë është arkëtuar:

- Nga 408 subjekte të biznesit të madh në vlerën 36 435 538 lekë, detyrime këto të vitit 2016 si dhe nga 206 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2016 në vlerën 13 018 603 lekë.
- Nga 1951 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 25 582 666 lekë, detyrime këto të vitit 2016 si dhe nga 357 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2016 në vlerën 5 012 283 lekë.
- Nga 3 organizata jo fitimprurëse në vlerën 62 256 lekë.
- Nga 144 pronarë ndërtesash të cilët ambientet e tyre jua kanë lëshuar me qira subjekteve të biznesit të madh apo të vogël në vlerën 7 395 411 lekë si dhe nga 59 pronarë ndërtesash debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2016 në vlerën 3 252 162 lekë.
- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2016 në vlerën 22 431 669 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qënë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2016 në vlerën 1 904 058 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2016 në vlerën 184 390 lekë, nga familjarë rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qënë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e

ndërtesës gjatë vitit 2016 në vlerën 43 232 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë në vlerën 4 731 269 lekë. Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizimin total të taksës së ndërtesës po i ilustruam grafikisht :




Realizimi në këtë masë vjen si rezultat i punës së kryer nga ana e inspektorëve në terren, pagimit brenda afateve ligjore nga familjarët, nga ana e subjekteve të Biznesit të Madh dhe Biznesit të Vogël, nga bashkëpunimi ndërmjet të gjitha drejtorive të Bashkisë, institucioneve të varësisë apo institucioneve të tjera si dhe nga zbatimi i masave shtrënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga subjektet debitorë. Nga viti në vit i është kushtuar vëmendje maksimale evidentimit të saktë të sipërfaqeve të ndërtesave për banim nga familjarët ashtu edhe ndërtesave në të cilat ushtrohet aktivitet privat në fushën e tregtisë dhe shërbimeve, por dhe ndërtesave në të cilat ushtrohet aktivitet privat në fushën e prodhimit. Gjithashtu po gjatë vitit 2016 fal punës në terren por edhe bashkëpunimit me zyrën e urbanistikës dhe inxhinierët e rajoneve është bërë e mundur identifikimi i 13 230.4 m², nga të cilat 3 650.4 m² sipërfaqe ndërtimi në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues, 5 891 m² sipërfaqe ndërtimi në të cilat ushtrohet aktivitet në fushën e tregtimit dhe shërbimit si dhe 3 689 m² sipërfaqe ndërtimi në pronësi të subjekteve private apo pronarëve të ndërtesave në të cilat nuk ushtrohet aktivitet privat.

Po ti referohemi tabelës të cilën po e paraqesim më poshtë duket qartë se prej vitit të parë të cilin e kemi paraqitur në mënyrë krahasuese për një hark kohor 5-vjeçar shohim një trend rritës nga viti në vit por sidomos duke krahasuar dy vitet e fundit, vite që mbas reformës administrative territoriale Bashkisë Korçë ju shtuan në administrim dhe 7 njësi administrative (ish komuna) fokusimi më i madh ishte në evidentimin, krijimin i një database në lidhje me detyrimet dhe arkëtimet ndër vitet, menaxhimin, arkëtimin e detyrimeve si dhe marrjen e masave shtrënguese për të gjitha subjektet të cilat nuk i kishin kryer pagesat brenda afateve të përcaktuara dhe pas njoftimeve të kryera nga ana jonë si për familjarët ashtu edhe për subjektet tregtuese dhe prodhuese të cilat ushtrojnë aktivitet në territoret administrative të këtyre njësive. Në vlerë krahasuese referuar dy viteve të fundit Bashkia Korçë ka arritur të arkëtojë një shumë prej 38 467 190 lekë më tepër se sa viti paraardhës.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës mbi ndërtesën për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Taksa mbi ndërtesën	43,777,278	45,728,925	67,425,174	81,586,347	120,053,537



TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
2	Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	15 000 000	4 412 297	29 %

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme e cila planifikohet dhe mbledhet nga agjenti tatimor i cili është ZVRPP Korçë, për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 15 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 29 % ose e shprehur në vlerë 4 412 297 lekë. Ky mos realizim vjen si rrjedhojë ndryshimeve ligjore që ndodhën gjatë vitit 2016 sidomos Ligjit 81/2016 “Për Rivlerësimin e Pasurisë së Paluajtshme” i cili ndikoi me një stopim të shitjeve që tatoheshin me 15%, pavarësisht se nga ana jonë prej vitit 2015 e në vazhdim duke patur për qëllim rritjen e transparencës midis dy institucioneve, fuqizuar nivelin e bashkëpunimit si dhe monitorimin e performancës së ZVRPP Korçë në lidhje me zërin tatim shitjeje pasuri e paluajtshme përveç akt rakordimit mujor kemi në dispozicion evidenca të detajuara me numrin, sipërfaqen dhe vlerën e objekteve të cilat kanë ndërruar pronësinë për çdo muaj.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016 :

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	3,828,227	6,461,126	5,663,311	9,231,294	4,412,297

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme



TAKSA MBI TRUALLIN

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
3	Taksa mbi truallin	0	4,709,608	

Taksa mbi truallin për vitin 2016 nuk ka pasur planifikim pasi është taksë e re e miratuar me paketën fiskale të vitit 2016 sipas ndryshimeve ligjore dhe mungesa e një database të të dhënave apo indentifikimi i saktë i sipërfaqeve të truallit që kishin në pronësi si subjektet private ashtu dhe familjarët ka qënë i vështirë që taksa mbi truallin të planifikohet nga momenti i miratimit të ligjit deri në përgatitjen e buxhetit të Bashkisë. Kjo taksë për vitin 2016 është arkëtuar në vlerë 4 709 608 lekë nga :

- Nga 116 subjekte të Biznesit të Madh në vlerën 3 569 062 lekë.
- Nga 60 subjekte të Biznesit të Vogël në vlerën 980 634 lekë.
- Nga familjarë në vlerën 159 912 lekë.

Realizimi në këtë masë vjen si rezultat i punës së kryer në terren në lidhje me informimin e poseduesve të truallit për detyrimin dhe afatet e pagesës, identifikimin e këtyre sipërfaqeve, matja e tyre në rastet e mungesës së dokumentacionit e cila gjatë vitit 2016 fal punës në terren por edhe bashkëpunimit me zyrën e urbanistikës me inxhinierët e rajoneve është bërë e mundur identifikimi i 22 583 m² sipërfaqe trualli në pronësi të subjekteve të biznesit të madh apo pronarëve në ambientet e të cilëve ushtrojnë aktivitet subjektete të biznesit të madh, 7 832 m² sipërfaqe trualli në pronësi të subjekteve të biznesit të vogël apo pronarëve në ambientet e të cilëve ushtrojnë aktivitet subjekte të biznesit të vogël dhe këtu vlen të theksohet

bashkëpunimi i frytshëm midis drejtorisë së përgjithshme të taksave dhe tarifave vendore dhe asaj të urbanistikës në lidhje me matjen e saktë të të gjitha sipërfaqëve të truallit në pronësi të të gjithë personave të cilët e shfrytëzojnë për përdorim familjar, pagimit brenda afateve ligjore nga familjarët dhe nga ana e subjekteve të Biznesit të Madh dhe Biznesit të Vogël, nga bashkëpunimi ndërmjet të gjitha drejtorive të bashkisë, institucioneve të varësisë apo dhe institucioneve të tjera.

TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
4	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël	40,000,000	11 870 476	30 %

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël në buxhetin e vitit 2016 është planifikuar 40 000 000 lekë dhe realizimi i tij deri në fund të vitit 2016 është në masën 30 % ose në vlerë 11 870 476 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i arkëtimit në vlerën 1 037 474 lekë si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga subjektet debitore nga ana e Bashkisë Korçë nga subjektet e Biznesit të Vogël detyrime këto nga vitet paraardhëse si taksë vendore dhe nga arkëtimi i vlerës 10 833 002 lekë të cilat janë derdhur për llogari të Bashkisë Korçë nga DRT Korçë nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël ku kjo e fundit bazuar në legjislacionin aktual në fuqi është në rolin e agjentit tatimor. Ky realizim i të ardhurave edhe për vitin 2016 sikundër dhe për vitet 2014-2015 vjen si pasojë e ndryshimeve të vazhdueshme të Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i cili vetëm për vitin 2015 dhe 2016 ka pësuar ndryshime të cilat ndikuan në kete nivel të ulët të arkëtimeve, konkretisht: Përgjate vitit 2015 forma e taksimit ishte:

- Biznese me xhiro nga zero në 2 milionë lekë, paguajnë një tatim fiks prej 25 mijë lekë në vit.
- Bizneset me qarkullim nga 2 deri në 5 milionë lekë në vit, paguajnë, **7.5%** tatim të thjeshtuar mbi fitimin e BV.
- Bizneset me qarkullim nga 5 deri në 8 milionë lekë në vit paguajnë **7.5%** tatim të thjeshtuar mbi fitimin e BV dhe janë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar.


Përgjatë vitit 2016 forma e taksimit u bë:

- Subjektet me xhiro nën 5 milionë lekë paguajnë **0 tatim** të thjeshtuar mbi fitimin e Biznesit të Vogël.
- Subjektet me qarkullim nga 5 deri në 8 milionë lekë paguajnë **5%** tatim të thjeshtuar mbi Biznesin e Vogël.

Ndryshimet ligjore dhe incentivat fiskale që u ndërmorën ndaj biznesit konkretisht ndaj biznesit të vogël, realizimi i këtij tatimi nga viti në vit ka pësuar rënie. Realizimi në këto vlera nuk duhet kuptuar si pamundësi apo mos-menaxhim i mirë në arkëtimin e këtij tatimi por si frymëmarje që ju dha biznesit dhe konkretisht biznesit të vogël duke e vlerësuar këtë të fundit për kontributin e tij në të ardhurat totale të Bashkisë por edhe si motorin e zhvillimit të ekonomive vendore. Në këto kushte dhe para këtij fakti mund të themi bindshëm se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël duke marrë si bazë krahasimi vetëm vitin 2015 me vitin 2016 ka një diferencë prej 44 195 032 lekë, por që këto lekë vërtet i munguan buxhetit të Bashkisë por ju shtuan arkës së bizneseve dhe konkretisht subjekteve të biznesit të vogël.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës vendore të Biznesit të Vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël për vitet 2012–2013 dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël për 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Taksë vendore B.V	89,192,648	82,769,863	41,487,797	56,065,508	11,870,476



TAKSA E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
5	Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor	30 000 000	23 195 018	77 %


Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor e cila planifikohet dhe mbledhet nga agjenti tatimor i cili është D.R.SH.T.RR Korçë, për vitin 2016 është planifikuar 30 000 000 lekë dhe realizimi i saj për vitin 2016 është në masën 77 % ose në vlerë 23 195 018 lekë. Duke filluar nga viti 2014 e në vazhdim duke patur për qëllim rritjen e transparencës midis dy institucioneve, fuqizuar nivelin e bashkëpunimit si dhe monitorimin e performancës së D.R.SH.T.RR Korçë në lidhje me këtë zë përveç akt rakordimit mujor kemi kërkuar dhe na janë vënë në dispozicion evidenca të detajuara me numrin dhe pronësinë e mjeteve si dhe vlerën e paguar për çdo mjet, për çdo muaj.

Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 2 540 110 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor për vitet 2012 – 2013 -2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor	23,380,418	21,497,777	16,648,777	20,654,908	23,195,018

Taksë rregjistrimi e përvitshme (automjete)



TARIFË REGJISTRIM BIZNESI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
6	Tarifë regjistrim biznesi	2 200 000	1 823 500	83 %

Tarifë regjistrim biznesi për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 2 200 000 lekë dhe është realizuar në masën 83 % ose në vlerën 1 823 500 lekë. Kjo tarifë prej vitit 2016 falë incentivave fiskale që Bashkia Korçë ndërmori u bë 0 lekë nga 20 000 lekë që ishte për Biznesin e Madh dhe 10 000 lekë që ishte për Biznesin e Vogël. Ky realizim vjen si rezultat i pagimit nga ana e subjekteve debitorë të regjistruara gjatë viteve të mëparshme por që pagimin e kësaj tarife e kryen përgjatë vitit 2016 si pasojë e masave shtrërnguese që Bashkia Korçë ndërmori ndaj këtyre subjekteve. Konkretisht arkëtimin e vlerës 1 823 500 lekë po e detajojmë sipas llojit të aktivitetit të subjekteve që pagimin e kësaj tarife e kryen përgjatë vitit 2016.


- Tarifë regjistrimi nga 18 subjekte të biznesit të madh është arkëtuar në vlerën 290 000 lekë
- Tarifë regjistrimi nga 139 subjekte të biznesit të vogël është arkëtuar në vlerën 1 411 000 lekë
- Tarifë regjistrimi nga 49 subjekte ambulante është arkëtuar në vlerën 122 500 lekë

Zerimi i kësaj tarife por dhe incentivat fiskale që Bashkia Korçë ndërmori bëri të mundur që gjatë vitit 2016 të regjistrohen 471 subjekte të reja nga të cilat 447 i përkasin kategorisë subjekte të biznesit të vogël dhe 24 i përkasin kategorisë subjekte të biznesit të madh.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së regjistrimit të biznesit për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016 :

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë regjistrim biznesi	2,746,500	2,770,000	3,165,000	6,032,500	1,823,500

Tarifë regjistrim biznesi



TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	90,000,000	64,598,635	72%

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 90 000 000 lekë, dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 72 % ose në vlerën 64 598 635 lekë. Kjo taksë është realizuar si pasojë e dhënies së lejave dhe arkëtimit të tyre konkretisht nga:


- 11 leje për objekte me funksion shërbime të cilat kanë paguar taksën në vlerën 6 797 849 lekë.
- 54 leje për objekte banimi dhe objekte banim/shërbim në vlerën 57 800 786 lekë

Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 56 085 938 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Taksë për ndërtimet e reja	4,929,863	118,347	1,695,305	8,512,697	64,598,635

Taksë për ndërtimet e reja



TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA LEGALIZIMET

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
8	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	18,000,000	8,218,906	46%


Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 18 000 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 46 % ose në vlerën 8 218 906 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i legalizimit të 133 objekteve dhe kryerjes së pagesës për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për këto objekte.

Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 3 965 103 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Taksë ndikimi në infrastrukturë nga legalizimet	4,563,744	2,735,019	449,262	4,253,803	8,218,906

Taksë ndikimi në infrastrukturë nga legalizimet



TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË (MINISTRIA E ENERGJISË)

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
9	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	0	1,804,439	

Kjo taksë është realizuar si rezultat i pagesës nga Ministria e Energjisë të vlerës 1 804 439 lekë për taksë ndikimi në infrastrukturë të investimeve të kësaj ministrie në rrjetin energjitik.

TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJË TRANSPORTI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
10	Tarifë regjistrimi për lejë transporti	1 500 000	1 235 530	82%

Tarifë regjistrimi leje transporti për vitin 2016 është planifikuar 1 500 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 82 % ose në vlerë 1 235 530 lekë. Realizimi i kësaj tarifë vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga:


- Transport malli për llogari të vet 330,820 lekë.
- Transport malli për të tretë 259,600 lekë.
- Transport udhëtarësh me taksi 333,690 lekë.
- Transport udhëtarësh me linjë qytetëse 11,500 lekë.
- Transport udhëtarësh me linja rrethqytetëse 41,650 lekë.
- Transport udhëtarësh me linjë ndërqytetëse 92,270 lekë.
- Autorizime kamioni të tonazhit të rëndë 71,000 lekë.
- Agjensi transporti udhëtarësh 95,000 lekë.

Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 114 073 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së regjistrim për leje transporti për vitet 2012 – 2013 - 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë rregjistrimi për leje transporti	853,305	221,000	493,880	1,121,457	1,235,530

Tarifë rregjistrimi për leje transporti



TAKSA E FJETJES NË HOTEL


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
11	Taksa e fjetjes në hotel	4 700 000	3 191 494	68%

Taksë fjetje në hotel për vitin 2016 është parashikuar 4 700 000 lekë dhe është realizuar në masën 68% ose në vlerën 3 191 494 lekë, këto nga subjektet që japin strehim kundrejt pagesës siç janë hotelet, motelet, bujtinat dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin administrativ të Bashkisë Korçë. Kjo vlerë u realizua si pasojë e arkëtimit të 2 689 890 lekë taksë fjetje në hotel për vitin 2016 dhe arkëtimit të 501 604 lekë detyrime këto të viteve të mëparëshme. Kjo taksë nuk u realizua në nivelin e parashikuar përpos ndryshimeve ligjore dhe lehtësive fiskale që pasuan vitin 2016 për këtë kategori biznesi dhe konkretisht për taksën e fjetjes në hotel ku deri në vitin 2015 paguhej 5% e cmimit të fjetjes dhe për vitin 2016 paguhej vetëm 70 lekë për person. Po ta analizojmë vlerën e arkëtuar përgjatë vitit 2016 krahasuar me vitin 2015 do shikojmë që ka një mos arritje të nivelit të arkëtimit me një vit më parë por në krahasim me nivelin e taksës që një vizitor paguante gjatë vitit 2015 në krahasim me nivelin e taksës që një vizitor paguante gjatë vitit 2016 themi me bindje se për realizimin e kësaj takse ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të vizitorëve dhe turistëve në qytet e cila kapi shifrat e 38 427 personave. Ky fluks në rritje i numrit të vizitorëve dhe turistëve ka sjellë dhe rritjen e numrit të subjekteve që operojnë dhe ofrojnë shërbimin në këtë fushë, konkretisht vetëm gjatë vitit 2016 janë hapur 6 subjekte të reja që ushtrojnë aktivitetin në këtë fushë. Ky faktor ritregon më së miri se Bashkia Korçë falë

lehtësive fiskale për të gjithë operatorët që ushtrojnë këtë lloj aktiviteti nga viti në vit po bëhet atraksion turistik jo më vetëm gjatë stinës së verës por gjatë gjithë vitit.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës fjetje në hotel për vitet 2012 – 2013– 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Taksë fjetje në hotel	1,886,089	1,786,448	1,666,638	3,327,481	3,191,494



TAKSË THERRJE BAGËTIE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
12	Taksë therreje bagëtie	1 000 000	571 200	57%

Taksë therreje bagëtie për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 1 000 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2016 është në masën 57 % ose në vlerën 571 200 lekë. Ky realizim ka ardhur si rezultat i therres së 7664 krerë bagëti gjatë vitit 2015 nga të cilat konkretisht:


- 1851 gjedhë në vlerën 370 200 lekë
- 3186 bagëti të imta në vlerën 159 300 lekë
- 834 derra në vlerën 41 700 lekë

Në krahasim me vlerën e parashikuar ka një mosrealizim në vlerën 428 800 lekë kjo si pasojë së prej muajit Korrik dhe deri në 15-ditëshin e dytë të muajit Shtator therretorja ka qënë mbyllur për shkak të rënies së sëmundjes të dermatozës modulare e cila pasoi dhe në muajt në vazhdim me një rënie të konsumit që solli dhe rënien e numrit të therreve në therretore.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksë therreje bagëtie për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016 :

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Taksë therreje bagëti	761,150	744,600	754,600	784,900	571,200

Taksë therrje bagëti



TAKSA E TABELËS

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
13	Taksa e tabelës	20 327 000	16 169 736	80 %


Taksa e tabelës për qëllime identifikimi dhe reklamimi për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 20 327 000 lekë dhe është realizuar në masën 80 % ose në vlerën 16 169 736 lekë. Kjo shumë është arkëtuar :

- Nga 9 subjekte të cilat kanë vendosur tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku ushtrojnë aktivitetin në formën dhe përmasat e tabelave të snjalistikës për orientim në vlerën 1 320 lekë.
- Nga 28 subjekte të cilat kanë vendosur tabelë për qëllime identifikimi mbi 2 m², të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brënda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve në vlerën 5 341 650 lekë.
- Nga 739 subjekte debitorë për vitet e mëparshme por që e kryen pagesën për taksën e tabelës gjatë vitit 2016 në vlerën 185 155 lekë.
- Nga 91 subjekte të cilat kanë vendosur tabelë për qëllime reklamimi të lëvizshme dhe të pa lëvizshme në vlerën 6 791 231 lekë.
- Nga 92 subjekte debitorë për vitet e mëparshme por që e kryen pagesën për taksën e reklamës gjatë vitit 2016 në vlerën 3 850 380 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së tabelës për vitet 2012 – 2013 - 2014 – 2015 dhe 2016:

Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Taksë table	261,280	247,250	250,970	356,529	12,319,356


Taksë Tabele



Po nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim të ilustruar dhe trendin e realizimit të taksës së reklamës për vitet 2012 – 2013 - 2014 – 2015 dhe 2016:

Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Taksë reklame	13,103,438	13,744,478	18,551,722	12,854,785	3,850,380

Taksë Reklame



TARIFË MUR PERIMETRAL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
14	Tarifë mur perimetral	1,300,000	400,438	31%

Tarifë mur perimetral për vitin 2016 është planifikuar 1 300 000 lekë dhe është realizuar në masën 31 % ose në vlerë 400 438 lekë. Ky realizim vjen si arkëtim nga :


- Leje të dhëna për objekte për banim në vlerën 323 318 lekë
- Leje të dhëna për objekte për shërbim dhe tregëti 77 120 lekë

Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 251 112 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës mur perimetral për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë mur perimetral	87,410	0	23,000	149,326	400,438

Tarifë mur perimetral



TARIFË PËR SHËRBIM ME TAVOLINA JASHTË LOKALIT


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
15	Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit	3 420 000	4 145 700	121 %

Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit për vitin 2016 është parashikuar në vlerën 3 420 000 lekë dhe është realizuar në masën 121 % ose në vlerën 4 145 700 lekë. Konkretisht 3 537 525 lekë detyrime të vitit 2016 dhe 608 175 lekë detyrime të viteve të kaluar të arkëtuara gjatë vitit 2016. Kjo tarifë është realizuar në masën 121 % si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmara nga ana e Bashkisë Korçë, në evidentimin e saktë nga ana e inspektorëve të numrit të tavolinave të Biznesit të Vogël dhe të Madh që vendosen jashtë ambjenteve të lokaleve si dhe në ndjekjen e arkëtimit të kësaj tarife brënda afateve të përcaktuara. Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 701 500 lekë më shumë sesa në vitin 2015. Ky realizim në rritje vjen si rezultat i punës në terren për zgjerim i bazës dhe jo si rritje e barrës fiskale mbi subjektet që shërbejnë me tavolina jashtë lokalit.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës për shërbim me tavolina jashtë lokalit për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016 :

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit	2,741,275	2,022,300	2,595,300	3,444,200	4,145,700

Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit




TARIFA E PASTRIMIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
16	Tarifa e Pastrimit	118 200 000	109 957 984.63	93 %

Tarifa e pastrimit për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 118 200 000 lekë dhe është realizuar në masën 93% ose në vlerë 109 957 984.63 lekë. Kjo shumë është arkëtuar:

- Nga 696 subjekte të biznesit të madh në vlerën 31 765 800 lekë, detyrime këto të vitit 2016 si dhe nga 294 subjekte të Biznesit të Madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2016 në vlerën 11 975 227 lekë.
- Nga 2622 subjekte të Biznesit të Vogël në vlerën 19 141 536 lekë, detyrime këto të vitit 2016 si dhe nga 700 subjekte të Biznesit të Vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2016 në vlerën 2 849 519 lekë.
- Nga 40 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 823 334 lekë detyrime këto të vitit 2016 si dhe nga 4 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2016 në vlerën 21 270 lekë.
- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2016 në vlerën 34 360 655 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qënë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2016 në vlerën 2 897 615 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2016 në vlerën 908 033.63 lekë, nga abonentët familjarë rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qënë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2016 në vlerën 482 729 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë në vlerën 4 732 266 lekë.


Realizimet e mësipërme sipas % që këto zëra zenë në realizmin total të tarifës së pastrimit po i ilustruamë grafikisht :



Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 36 259 191 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së pastrimit për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë pastrimi	49,719,607	58,843,384	62,825,304	73,698,794	109,957,985



TARIFË SHËRBIMI, VËRTETIME, CERTIFIKATA


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
17	Tarifë shërbimi, vërtetime, certifikata	13 000 000	10 999 655	85 %

Të ardhura të tjera (tarifa shërbimi, vërtetime, çertifikata, etj), për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 13 000 000 lekë dhe është realizuar në masën 85 % ose në vlerën 10 999 655 lekë. Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 1 208 191 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifave të shërbimit, vërtetime, çertifikata, etj për vitet 2012 – 2013- 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata	5,991,427	5,925,621	10,526,585	9,791,464	10,999,655

Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata



ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
18	Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri	0	583 800	

Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri për vitin 2016 është realizuar në vlerën 583 800 lekë. Konkretisht janë lëshuar 60 çertifikata për mbrojtjen nga zjarri prej të cilave 54 kanë qënë rinovim çertifikate dhe 6 çertifikata kanë qënë për herë të parë. Më të detajuara po i paraqesim më poshtë:

- 42 çertifikata të tregut të karburanteve, pikave të GLN, autoboteve të karburantit dhe GLN.
- 13 çertifikata të bankave të nivelit të dytë.
- 2 çertifikata të subjekteve tregëtare dhe prodhuese
- 1 çertifikatë për objekte kolektive banimi
- 1 çertifikatë për objekte zyrash
- 1 çertifikatë ambiente mësimdhënie

MIRATIM PROJEKTI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
19	Miratim projekti	0	297 500	

Miratim projekti për vitin 2016 është realizuar në vlerën 297 500 lekë. Kjo tarifë arkëtohet konkretisht nga miratimi i projekteve të mbrojtjes nga zjarri për çdo lejë ndërtimi dhe konkretisht gjatë vitit 2016 janë miratuar 47 të tilla.

MARRJE ME QIRA PYLLI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
20	Marrje me qira pylli	86 850	86 850	100%

Marrje me qira pylli për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 86 850 lekë dhe është realizuar në masën 100 % ose në vlerën 86 850 lekë. Janë të ardhura të mbartura dhe të derdhura nga Ministria e Mjedisit për llogari të Bashkisë Korçë.

HEQJE MATERIALI DRUSOR

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
21	Heqje materiali drusor	25 965	25 965	100%

Heqje materiali drusor për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 25 965 lekë dhe është realizuar në masën 100 % ose në vlerën 25 965 lekë. Janë të ardhura të mbartura të dhe derdhura nga Ministria e Mjedisit për llogari të Bashkisë Korçë.

TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
22	Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit	8 735 476	8 735 476	100%

Të ardhura nga shitja e drurëve të zjarrit për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 8 735 476 lekë dhe është realizuar në masën 100 % ose në vlerën 8 735 476 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga 2 kontrata të rinegociuara, konkretisht nga kontrata e një subjekti me vlerën 3 731 800 lekë dhe kontrata e një subjekti tjetër në vlerën 5 003 676 lekë.

QIRA PËR KULLOTA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
23	Qira për kullota	457 600	532 600	116%

Qira për kullota për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 457 600 lekë dhe është realizuar në masën 116 % ose në vlerën 532 600 lekë. Aktualisht janë 18 kontrata qiraje me vlerë totale 592 600 lekë dhe brenda vitit 2016 janë arkëtuar 17 kontrata në vlerën 532 600 lekë. Mbetet për tu arkëtuar dhe 1 kontratë qiraje në vlerën 60 000 lekë.

TARIFË PARKIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
24	Tarifë Parkimi	16,000,000	16,475,497	103%

Tarifë parkimi për vitin 2016 është planifikuar 16,000,000 lekë dhe deri në fund të vitit 2016 është realizuar në masën 103 % ose në vlerë 16,475,497 lekë. Realizimi i kësaj tarife vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga:


- Tarifa e parkimit të rezervuar për institucionet apo subjektet për vitin 2016 por dhe për ato paraardhëse në vlerën 778,480 lekë

- Tarifa e parkimit për shërbimin e transportit të udhëtarëve me taksi për vitin 2016 por dhe për ato paraardhëse në vlerën 284,667 lekë
- Tarifa e parkimit të subjekteve transportit të udhëtarëve që operojnë me linja ndërqytetëse për vitin 2016 por dhe për ato paraardhëse në vlerën 2,395,950 lekë
- Tarifë parkimi e arkëtuar nga subjekti i kontraktuar për vjeljen e tarifës së parkimit në qytet në vendparkimet e miratuara me pagesë në vlerën 13,016,400 lekë.

Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 3 008 570 lekë më shumë se sa në vitin 2015. Kjo vlerë vjen si rezultat i rritjes së performancës së subjektit të kontraktuar për shkak të kontrolleve të kryera nga ana jonë në vend parkimet e miratuara me pagesë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të Tarifës së Parkimit për vitet 2012 – 2013 – 2014– 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë parkimi	2,422,740	1,943,306	5,480,070	13,466,927	16,475,497



GJOBA POLICIA BASHKIAKE


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
25	Gjoba Policia Bashkiake	1,500,000	1,095,000	73 %

Gjoba Policia Bashkiake për vitin 2016 është planifikuar 1,500,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2016 është në masën 73% ose në vlerën 1,095,000 lekë.

Gjatë vitit 2016 në total janë vendosur 846 gjoba në vlerën 1 192 000 lekë nga të cilat 800 janë arkëtuar brenda vitit 2016 në vlerën 1 070 000 lekë dhe 46 gjoba për vlerën 122 000 lekë janë të pa arkëtuara. Gjithashtu po brenda vitit 2016 janë arkëtuar dhe 20 gjoba në vlerën 25 000 lekë të pa arkëtuara këto nga vitet e mëparëshme dhe mbetën për tu arkëtuar dhe 8 gjoba në vlerë 16 000 lekë nga vitet e mëparëshme për të cilat po ndiqen të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e tyre.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të zërit gjoba Policia Bashkiake për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016 :

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Gjoba policia bashkiake	42,000	19,000	22,000	208,000	1,095,000



GJOBË PËR VONESË NË PAGESË


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
26	Gjoba për vonesë në pagesë	8,600,000	6,293,881	73 %

Gjoba për vonesë në pagesë për vitin 2016 është planifikuar 8 600 000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2016 është në masën 73 % ose në vlerën 6 293 881 lekë. Ky zë është realizuar në vlerën 116 537 lekë nga subjektet debitore të biznesit të vogël të krijuar deri në vitin 2013 kur këto subjekte paguanin pranë Bashkisë Korçë taksën vendore të biznesit të vogël dhe të arkëtuara gjatë vitit 2016 nga zbatimi i masave shtrënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga subjektet debitore dhe në vlerën 6 177 344 lekë nga subjektet e biznesit të vogël, subjektet e biznesit të madh, pronarët e ndërtesave apo ata të tokave bujqësore të arkëtuara gjatë vitit 2016 nga zbatimi i masave shtrënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga subjektet debitorë por dhe të atyre subjekteve të cilët kanë likuiduar taksat dhe tarifat lokale jashtë afateve të miratuara në Vendimin e Këshillit të Bashkisë për vitin 2016.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të gjobave për vonesë në pagesë për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Gjobë për vonesë në pagesë	619,873	757,239	447,455	2,204,066	6,293,881

Gjobë për vonesë në pagesë



GJOBA TË INSPEKTORIATIT NDËRTIMOR VENDOR


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
27	Gjopa të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor	6,000,000	900,000	15%

Gjopa të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 6.000.000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2016 është në masën 15 % ose në vlerën 900 000 lekë. Konkretisht gjatë vitit 2016 janë vendosur gjithsej 12 gjopa në vlerë 2 050 000 lekë prej të cilave janë likujduar brenda vitit 2016, 8 gjopa në vlerë 900 000 lekë dhe mbeten për tu vjelë 4 gjopa me vlerë 1 150 000 lekë. Gjithashu vazhdojnë të jenë në ekzekutim nga përmbarimi 10 gjopa në vlerë 1 980 000 lekë dhe në proces gjyqësor vazhdojnë të jenë 4 gjopa në vlerë 3 050 000 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të gjobave të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016 :

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Gjopa të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor	1,120,000	2,030,000	1,390,000	730,000	900,000

Gjopa të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor



GJOBA TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
28	Gjoba të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit	1,500,000	656,100	44%

Gjoba të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 1 500 000 lekë, dhe është realizuar në masën 44 % ose në vlerën 656 100 lekë.

Gjatë vitit 2016 në total janë vendosur 102 gjoba në vlerën 901 100 lekë nga të cilat 70 gjoba janë arkëtuar brënda vitit 2016 në vlerën 556 100 lekë, gjithashtu po gjatë vitit 2016 janë likujduar gjobat e pambledhura për vitet 2014 dhe 2015 konkretisht 6 gjoba të vitit 2015 në vlerë 85 000 lekë dhe 2 gjoba të vitit 2014 në vlerën 15 000 lekë. Mbeten të pa arkëtuara 32 gjoba në vlerën 345 000 lekë për të cilat po ndiqen të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e tyre gjatë këtij viti.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të gjobave të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Gjoba të drejtorisë së kontrollit të territorit	125,000	55,000	33,000	149,000	656,100

Gjoba të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit**QERA OBJEKTI, QERA TRUALLI DHE QERA TOKË BUJQËSORE**

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
29	Qira objekti, Qira Trualli, Qira T.bujqësore e.t.j	1,425,240	3,668,608	257%

Qera objekti, qera trualli, qera tokë bujqësore e.t.j për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 1 425 240 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2016 është në masën 257 % ose në vlerën 3 668 608 lekë. Konkretisht realizimi i këtij zëri në këtë nivel vjen si rezultat i :


- Arkëtimit të 2 640 297 lekë nga zëri qira trualli.
- Arkëtimit të 928 950 lekë nga zëri qira objekti.
- Arkëtimit të 99 361 lekë nga zëri qira tokë bujqësore.

Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 1 470 545 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të zërit qera objekti për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Qira objekti, Qira Trualli, Qira Tokë bujqësore e.t.j	1,550,338	819,935	1,305,032	2,198,063	3,668,608

Qira objekti, Qira Trualli, Qira Tokë bujqësore e.t.j



TARIFË PËR DHËNIEN E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
30	Tarifë për dhënie e treguesve të zhvillimit	1,000,000	287,000	29 %


Tarifë për dhënie e treguesve të zhvillimit për vitin 2016 është planifikuar 1 000 000 lekë, dhe është realizuar në masën 29 % ose në vlerën 287 000 lekë.

Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 197 000 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së plan vendosjes për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016 :

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë për dhënie e treguesve të zhvillimit	0	0	192,000	90,000	287,000

Tarifë për dhënien e treguesve të zhvillimit




TARIFË NDRIÇIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
31	Tarifë Ndriçimi	38,130,000	36,317,435	95%

Tarifa e ndriçimit për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 38 130 000 lekë dhe është realizuar në masën 95% ose në vlerë 36 317 435 lekë. Kjo shumë është arkëtuar:

- Nga 671 subjekte të biznesit të madh në vlerën 6 070 617 lekë, detyrime këto të vitit 2016 si dhe nga 196 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2016 në vlerën 1 617 496 lekë.
- Nga 2623 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 10 839 920 lekë, detyrime këto të vitit 2016 si dhe nga 463 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2016 në vlerën 968 804 lekë.
- Nga 40 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 205 833 lekë detyrime këto të vitit 2016 si dhe nga 4 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2016 në vlerën 8 109 lekë.
- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2016 në vlerën 9 827 264 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qënë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2016 në vlerën 1 071 950 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2016 në vlerën 346 759 lekë, nga familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qënë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2016 në vlerën 183 109 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë në vlerën 5 177 574 lekë.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizmin total të tarifës së ndriçimit po i ilustron grafikisht :




Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 8 768 433 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Duhet të theksojmë se realizimi në këtë masë vjen si rezultat i punës së kryer nga ana e inspektorëve në terren, pagimit brenda afateve ligjore nga familjarët, nga ana e subjekteve të Biznesit të Madh dhe Biznesit të Vogël, nga bashkëpunimi ndërmjet të gjitha drejtorive të Bashkisë, institucioneve të varësisë apo institucioneve të tjera si dhe nga zbatimi i masave shtrënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga subjektet debitore.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së ndriçimit për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë ndriçimi	15,424,960	17,774,749	23,704,862	27,549,002	36,317,435

Tarifë ndriçimi




TARIFË GJELBËRIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
32	Tarifë Gjelbërimi	20,865,000	22,321,664	107 %

Tarifa e gjelbërimit për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 20 865 500 lekë dhe është realizuar në masën 107 % ose në vlerë 22 321 664 lekë. Kjo shumë është arkëtuar:

- Nga 665 subjekte të biznesit të madh në vlerën 3 561 329 lekë, detyrime këto të vitit 2016 si dhe nga 187 subjekte të Biznesit të Madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2016 në vlerën 900 316 lekë.
- Nga 2296 subjekte të Biznesit të Vogël në vlerën 8 501 745 lekë, detyrime këto të vitit 2016 si dhe nga 418 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2016 në vlerën 498 718 lekë.
- Nga 40 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 205 833 lekë detyrime këto të vitit 2016 si dhe nga 4 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2016 në vlerën 5 763 lekë.
- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2016 në vlerën 7 500 113 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qënë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2016 në vlerën 770 464 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2016 në vlerën 247 768 lekë, nga familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qënë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2016 në vlerën 129 615 lekë.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizmin total të tarifës së gjelbërimit po i ilustrimë grafikisht :



Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 5 096 775 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Duhet të theksojmë se realizimi në këtë masë vjen si rezultat i punës së kryer nga ana e inspektorëve në terren, pagimit brenda afateve ligjore nga familjarët, nga ana e subjekteve të Biznesit të Madh dhe Biznesit të Vogël, nga bashkëpunimi ndërmjet të gjitha drejtorive të bashkisë, institucioneve të varësisë apo institucioneve të tjera si dhe nga zbatimi i masave shtrënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga subjektet debitore.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së gjellbërimit për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë gjellbërimi	10,545,989	12,084,452	15,503,114	17,224,889	22,321,664




TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONË PUBLIKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
33	Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike	1 635 000	1 238 474	76 %

Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike për vitin 2016 është planifikuar 1 635 000 lekë dhe është realizuar në masën 76 % ose në vlerën 1 238 474 lekë. Për planifikimin e këtij zëri jemi bazuar në të dhënat e marra nga grupi i punës i cili ka inventarizuar dhe matur në terren sipërfaqet e subjekteve që kanë zënë prona publike për zhvillimin e aktivitetit të tyre dhe realizimi vjen si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmara nga ana e Bashkisë Korçë si dhe është ndjekur me përparësi vjelja e këtij detyrimi nga subjektet dhe pronarët të cilët duhet ta paguajnë këtë tarifë brenda afateve të përcaktuara. Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 581 106 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës për servitutin e kalimit në pronë publike për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike	377,060	337,820	679,464	657,368	1,238,474

Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike**TARIFË PËRDORIMI I TREGUT TË LIRË TË QYTETIT**

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
34	Tarifë përdorimi i tregut të lirë të qytetit	0	519 530	


Tarifë përdorimi tregu i lirë i qytetit për vitin 2016 nuk është planifikuar dhe është realizuar në vlerën 519 530 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmara

nga ana e Bashkisë Korçë për subjektet debitore që nuk e paguan këtë tarifë brenda vitit 2015 por dhe atyre paraardhese, pasi për vitin 2016 falë incentivave fiskale që Bashkia Korçë ndërmori ndaj biznesit kjo tarifë u bë 0 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së përdorimit të tregut të lirë të qytetit për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë përdorimi i tregut të lirë të qytetit	5,316,780	501,160	4,262,690	2,646,420	519,530

Tarifë përdorimi i tregut të lirë të qytetit



TARIFË LEJË PËRDORIMI KANTINA


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
35	Tarifë lejë përdorimi kantina	500 000	14 750	3 %

Tarifë lejë veprimtarie kantina për vitin 2016 është planifikuar 500 000 lekë dhe është realizuar në masën 3 % ose në vlerën 14 750 lekë. Ky mosrealizim vjen si shkak i largimit nga hapësirat publike të subjekteve të cilat për shkak të përfundimit të investimeve publike por dhe zhvendosjes së stacionit të furgonave që niseshin për në rrethet e tjera nga zona e ish U.M.B ka bërë që këto subjekte të ndërpresin lejën e aktivitetit. Pra këto dy faktorë të përmendur bënë të pamundur realizimin e kësaj tarife.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të zërit tarifë lejë përdorimi kantina për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë lejë përdorimi kantina	1,081,351	824,450	915,100	787,970	14,750

Tarifë leje përdorimi kantina




TARIFË PËR EKSPOZIM MALLI JASHTË DYQANIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
36	Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit	385 000	289 650	75 %

Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit për vitin 2016 është planifikuar 385 000 lekë dhe është realizuar në masën 75 % ose në vlerën 289 650 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmara nga ana e Bashkisë Korçë për subjektet debitore që nuk e paguan këtë tarifë brenda vitit 2015 por dhe atyre paraardhese, pasi për vitin 2016 falë incentivave fiskale që Bashkia Korçë ndërmori ndaj biznesit kjo tarifë u bë 0 lekë. Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës për ekspozim malli jashtë dyqanit për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit	981,150	714,750	1,120,100	1,461,000	289,650

Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit



TARIFË PËR ZËNIE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
37	Tarifë për zënien e hapësirave publike	5,543,000	7,491,437	135 %


Tarifë për zënie hapësire publike për vitin 2016 është planifikuar 5,543,000 lekë dhe është realizuar në masën 135 % ose në vlerën 7,491,437 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmara nga ana e Bashkisë Korçë, si rezultat i punës së kryer nga inspektorët të cilët kanë inventarizuar dhe matur në terren sipërfaqet për zënien e hapësirave publike si dhe në ndjekjen e arkëtimit të kësaj tarife brenda afateve të përcaktuara. Me konkretisht dhe më të detajuar po e paraqesim më poshtë:

Tarifë për zënien e hapësirave publike	Vlera/lekë
Tek inkubatori i biznesit (ish U.M.B)	2,755,538
Në tregje të miratuara nga bashkia	876,960
Shërbim me tavolina jashtë lokalit	2,574,409
Promocione dhe panaire	707,000
Detyrime të prapambetura	577,530
Totali	7,491,437

Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 6 854 003 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës për zënie hapësire publike për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016 :

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë për zënie hapësire publike	283,457	355,005	447,965	637,434	7,491,437

Tarifë për zënie hapësire publike


TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
38	Taksa mbi tokën bujqësore	17 170 000	22 450 806	131 %

Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2016 është planifikuar 17 170 000 lekë dhe është realizuar në masën 131 % ose në vlerën 22 450 806 lekë. Kjo shumë është arketuar nga:

- Poseduesit e tokës bujqësore në Njësine Administrative Korçë në vlerën 1 177 842 lekë
- Poseduesit e tokës bujqësore në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë përveç Njësine Administrative Korçë në vlerën 21 272 964 lekë

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizmin total të taksës së tokës bujqësore po i ilustruam grafikisht :




Siç duket nga tabela por edhe nga shpjegimi që bëmë më sipër kemi një realizim të tejkaluar nga planifikimi i cili rrjedh si rezultat dhe i mungesës së informacionit të plotë në lidhje me sipërfaqet, bonitetet, pronarët apo përdoruesit e tokës bujqësore në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë përveç Njësies Administrative Korçë. Rol të rëndësishëm në këtë realizim ka luajtur informimi, njoftimi, ndjekja e pagimit të detyrimeve për vitin korrent sidomos në njësitë administrative por dhe zbatimi i masave shtrënguese të ndërmara nga ana e Bashkisë Korçë për detyrime të pambledhura nga vitet e mëparëshme.

Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 12 374 303 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës mbi tokën bujqësore për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Taksa mbi tokën bujqësore	3,760,957	439,137	949,248	10,076,503	22,450,806

Taksa mbi tokën bujqësore



TË ARDHURA NGA QIRATË (BANESAT SOCIALE)

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
39	Të ardhura nga qiratë (banesa sociale)	6 961 744	6 895 065	99 %


Të ardhurat nga qeratë, (banesa sociale) për vitin 2016 është planifikuar 6 961 744 lekë dhe është realizuar në masën 99 % ose në vlerën 6 895 065 lekë.

Në arkëtimin prej 6,895,065 lekë të qirave nga banesat sociale të ndërtuara me bashkëfinancim nga fonde të Bashkise Korce, Buxheti i Shtetit dhe nga CEB, përveç se janë arkëtuar qiratë korente janë arkëtuar përfundimisht detyrimet e prapambetura nga viti 2013 në masën 99.765 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të ardhura nga qiratë (banesa sociale) për vitet 2012 – 2013 – 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardh nga qiratë, banesa sociale	0	0	3,587,703	6,583,953	6,895,065

Të ardh nga qiratë, banesa sociale



TAKSË E PËRKOHSHME PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKËSORE
(TELEFONI, ENERGJI, TV KABLLOR, INTERNET)

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
40	Taksë e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore	3 120 000	1 884 000	60 %

Taksa e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore për vitin 2016 është planifikuar në vlerën 3 120 000 lekë dhe gjatë vitit 2016 është arkëtuar vlera 1 884 000 leke. Kjo vlerë ka erdhur si vazhdim i ndjekjes së procedurave ligjore të arkëtimit të vlerës 1 872 000 lekë nga një subjekt detyrime këto deri në fund të vitit 2014 dhe detyrimit prej 12 000 leke i një subjekti për vitin 2016. Duhet theksuar se është bërë e mundur sigurimi në bankë i detyrimit të vitit 2015 dhe 2016 për një subjekt debitor për të cilin jemi në vazhdim të procesit gjyqësor por njëkohësisht po vazhdojnë procedurat ligjore dhe për subjektet e tjera të cilat detyrohen ta paguajnë këtë taksë.

QIRA NGA BANESAT QË KANË KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË NGA
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
41	Qira nga banesat që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Korçë nga Enti Kombëtar i Banesave	4 793 300	3 177 200	66 %

Të ardhurat nga qiratë, (banesa në pronësi të bashkisë enti i banesave) për vitin 2016 është planifikuar 4 793 300 lekë dhe është realizuar në masën 66 % ose në vlerën 3 177 200 lekë. Në arkëtimin prej 3.177.200 lekë nga qiratë banesave sociale të dorëzuara nga EKB përvec qirasë korente janë arkëtuar dhe detyrime të prapambetura prej vitit 2013 në vlerën 281,891 leke. Për realizimin e të ardhurave nga qiratë e banesave sociale të dorëzuara nga EKB në shifrën 66% në analizën tonë rezulton se mosrealizimi vjen nga fakti që 4 apartamente vazhdojnë të jenë pa kontratë dhe për pasojë me detyrime të pashlyera prej vitit 2010, për këto 4 raste dhe nga takimet me familjarët, me shqyrtimin e dokumentacionit që ata na vunë në dispozicion u konstatua se problematikat që ata kanë janë: mbivendosje pronësie, vendime gjyqate të pazbatuara, pretendime për status të përndjekuri, trajtim me strehim në kompesim të pronës.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të ardhura nga qiratë (banesa në pronësi të bashkisë enti i banesave) për vitet 2012 – 2013– 2014 – 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Qira nga banesat që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Korçë nga Enti Kombëtar i Banesave	0	0	4,678,958	3,743,702	3,177,200

Qira nga banesat që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Korçë nga Enti Kombëtar i Banesave



KAMATË VONESA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
42	Kamatë vonesa	0	196 988	0

Kamatë vonesa për vitin 2016 është realizuar në vlerën 196 988 lekë. Kjo vlerë vjen si rezultat i mospagimit në afatet e përcaktuara të qirave të banesave sociale por dhe atyre që kanë kaluar në pronësi nga enti kombëtar i banesave.

TARIFË MIRËMBAJTJE VAREZA PUBLIKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
43	Tarifë mirëmbajtje vareza publike	14,180,000	10,597,898	75 %

Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike për vitin 2016 është planifikuar 14 180 000 lekë dhe është realizuar në masën 75 % ose në vlerën 10 597 898 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga:


- Familjarët rezidentë efektivë të cilët paguajnë tarifën e mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësinë Administrative Korçë në vlerën 7 423 550 lekë
- Familjarët rezidentë efektivë të cilët paguajnë tarifën e mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë përveç Njësive Administrative Korçë në vlerën 3 174 348 lekë.

Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 9 538 421 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të të ardhurave nga tarifa mirëmbajtje varreza publike për vitet 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë mirëmbajtje varreza publike	0	0	0	1,059,477	10,597,898

Tarifë mirëmbajtjeje varreza publike



TARIFË UJI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2016	Realizimi 2016	Përqindja
44	Tarifë uji	4 109 706	2 560 664	62 %


Tarifa e ujit për vitin 2016 është planifikuar 4 109 706 lekë dhe është realizuar në masën 62 % ose në vlerën 2 560 664 lekë. Ky realizim në këtë masë vjen si rezultat se prej muajit qershor 2016 e në vazhdim të gjitha ujësjellësat i kaluan për menaxhim Ndermarjes U.K.KO dhe për pasojë që nga ky moment arkëtimet për tarifën e ujit për vitin 2016 bëhen nga kjo ndërmarrje. Që prej muajit qershor vazhdojnë të arkëtohen të gjitha debitë për tarifën e ujit të akumuluar në vite në çdo njësi administrative të Bashkisë Korçë me përjashtim të Njesisë Administrative Korçë.

Po ta krahasojmë realizimin e vitit 2016 me realizimin e vitit 2015 na rezulton që gjatë vitit 2016 të kemi arkëtuar një shumë prej 343 808 lekë më shumë se sa në vitin 2015.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të ardhura nga tarifë uji për vitet 2015 dhe 2016:

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Tarifë uji	0	0	0	2,216,856	2,560,664

Tarifë uji




II. REALIZIMI I SHPENZIMEVE TË BASHKISË PËR VITIN 2016

Realizimi i shpenzimeve sipas programeve dhe ndarjeve ekonomike jepet si më poshtë:

Shpenzimet sipas programeve

	Viti 2013	%	Viti 2014	%	Viti 2015	%	Viti 2016	%
Administrim I përgjithshëm	197,902	39%	166,756	28%	207,841	25%	292,737	34%
Shërbimet Publike	140,514	28%	214,967	41%	413,885	49%	348,127	40%
Arsimi parauniversitar	78,204	15%	86,378	15%	107,606	13%	81,848	9%
Kulturë dhe sport	88,522	17%	98,512	16%	107,058	13%	137,485	16%
Transporti urban	5,456	1%	6,398	1%	6,982	1%	7,000	1%
Totali	510,598	100%	573,011	100%	843,372	100%	867,197	100%


Paraqitja grafike



Shpenzimet sipas ndarjes ekonomike

	Viti 2013	%	Viti 2014	%	Viti 2015	%	Viti 2016	%
Paga dhe sigurime shoqerore	186,856	37%	178,033	31%	208,337	25%	264,411	30%
Shpenzime operative	242,161	47%	282,995	49%	386,716	46%	430,791	50%
Shpenzime te tjera	44,323	9%	33,764	6%	31,566	4%	49,640	6%
Investime	37,258	7%	78,219	14%	216,753	26%	122,355	14%
Totali	510,598	100	573,011	100%	843,372	100%	867,197	100%

Paraqitja grafike

**Programi i administrimit të përgjithshëm****✓ Shpenzime për paga**

Shpenzimet për paga për punonjësit e administratës së Bashkisë, NJA dhe Institucioneve të Varësisë janë realizuar në bazë të VKM nr. 586 datë 17.7.2013 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619 dt. 02.07.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, VKM nr. 929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar.

Numri i punonjësve të administratës së Bashkisë dhe Njësive Administrative për vitin 2016 ka qënë 169.

Fondi i planifikuar për paga për vitin 2016 ishte në vlerën 119,738 mijë lekë. Realizimi për vitin 2016 ka qënë në vlerën 101,831 mijë lekë ose 85%.

Në zbatim të VKM nr.929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” të ndryshuar, si dhe sipas Urdhërave të Kryetarit të Bashkisë fondi i veçantë u përdor për:

-150 mijë lekë për zhvillimin e aktivitetit me rastin e 8 Marsit.

-118 mijë lekë rast pensioni, sëmundje dhe rast fatkeqësie e detajuar si më poshtë:

38 mijë lekë rast pensioni

50 mijë lekë rast sëmundje

30 mijë lekë rast fatkeqësie

✓ **Shpenzime për sigurime shoqërore**

Fondi i planifikuar për vitin 2016 ka qënë në vlerën 18,554 mijë lekë. Realizimi i këtij fondi ka qënë në vlerën 15,599 mijë lekë ose 84% .

✓ **Shpenzimet operative (mallra dhe shërbime)**

Fondi i planifikuar për shpenzime operative në programin e administrimit të përgjithshëm gjatë vitit 2016 ka qënë 73,396 mijë lekë nga të cilat 4,892 mijë lekë janë shpenzime operative (detyrime të NJA nga fondi tranzitor).

Realizimi i shpenzimeve operative për vitin 2016 ishte 59,234 mijë lekë ose 81% nga të cilat 3,565 mijë lekë është realizimi i shpenzimeve operative (detyrimet) nga fondi tranzitor paraqitet i detajuar si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Përshkrimi i shpenzimit	Fakt 2015	Pl 2016	Fakt 12m 2016	Det 2016	Dif Pl16-F16	%	Dif F16-F15	%
1	TELEKOM+POSTA	1,009	2,116	1,762	1	354	83%	753	175%
2	ABONIM INTERNET ADSL	200	854	816		38	96%	616	408%
3	TELEFON PA PAGESE	1	5			5	0%	(1)	0%
4	ENERGJIA ELEKTRIKE	4,020	6,510	5,194		1,316	80%	1,174	129%
5	PAGESE UJI	347	1,161	852	1	309	73%	505	246%
6	UDHETIME DHE DIETA	1,549	2,000	1,977		23	99%	428	128%
7	RIPARIM E PAJISJE MAKINASH	324	1,466	1,411		55	96%	1,087	435%
8	KARBURANT MAKINA+NGROHJE	10,297	8,000	7,651	181	349	96%	(2,646)	74%
9	PRODH DHE TRANSMETIM SPOTI DHE NJOFTIME	34	500	12		488	2%	(22)	35%
10	PRODHIMI I REVISTES QYTETI IM		780	282	187	498	36%	282	#DIV/0!
11	MEREMETE ,LYERJE DHE PUNIME ELEKTRIKE NE BASHKI DHE RAJONE		4,300	2,030	2,135	2,270	47%	2,030	#DIV/0!
12	SHTESE MEREMETE ,LYERJE DHE PUNIME ELEKTRIKE NE BASHKI DHE RAJONE		267		267	267	0%	-	#DIV/0!
13	MBIKQYRJE MEREMETE ,LYERJE DHE PUNIME ELEKTRIKE NE BASHKI DHE RAJONE		147		21	147	0%	-	#DIV/0!
14	KOLAUDIME MEREMETE ,LYERJE DHE PUNIME ELEKTRIKE NE BASHKI DHE RAJONE		14			14	0%	-	#DIV/0!
15	SHPENZIME PRITJE		150			150	0%	-	#DIV/0!
16	MATERIALE ELEKTRIKE DHE HIDRAULIKE	179	450	249	16	201	55%	70	139%
17	VESHJE,UNIFORMA POLICIA	246	239	143		96	60%	(103)	58%
18	SIGURACION MAKINE NDERTESE DHE KONTROLL TEKNIK	482	800	497		303	62%	15	103%
19	SHPENZIME TE TJERA	539	520	471	180	49	91%	(68)	87%
20	ORGANIZIMI FESTES 8 MARSIT	117	150	123		27	82%	6	105%
21	SHPENZIME Q.K.P. M.POTER	696	800	800		-	100%	104	115%
22	LETET SHKRIMI FOTOKOPJIMI KANCELARI	560	950	741		209	78%	181	132%
23	MATERIALE KONSUMI	144	578	462		116	80%	318	321%

RAPORT FINANCIAR 2016

BASHKIA KORÇË

24	RIPARIM FOTOKOPJE DHE PAISJE TE NDRYSHME	153	300	229		71	76%	76	150%
25	RUAJTJA E BASHKISE ETJ	3,550	7,746	7,402		344	96%	3,852	209%
26	BOJE PRINTERI E FOTOKOPJUES	607	1,091	887		204	81%	280	146%
27	SHPENZIME PER SHKOLLEN E MALTES	600	700	700		-	100%	100	117%
28	VENDIME GJYQESORE	10,616	11,117	11,040		77	99%	424	104%
29	REGJISTRIMI PRONAVE BASHKI	532	452	250		202	55%	(282)	47%
30	FOND PER PERBALLIMIN E SHP TE VARRIMIT PER INVALIDIN E LUFTES KRISTAQ JANAQ		150	150		-	100%	150	#DIV/0!
31	BLOQE ADMINISTRATIVE	255	600	592		8	99%	337	232%
32	MAT PROMOCIO (FTESA, FLETEPALOSJE,KARTOLINA, ALBUME)	291	1,208	490	672	718	41%	199	168%
33	VIEZIMI I RRUGEVE	2,227	-			-	#DIV/0!	(2,227)	0%
34	SHP MIREMB E PROGRAMIT TE MENAXHIMIT TE TAKSAVE	480	900	888		12	99%	408	185%
35	LIDHJA ME INF (MIRATIMI NGA UKKO, E MNZ ETJ)		-			-	#DIV/0!	-	#DIV/0!
36	KONTRATA E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE NGA OSHEE KORCE TE OBJEKTIT QENDRA PER PROMOVIMIN E KULTURES		243	243		-	100%	243	#DIV/0!
37	VLERESIMI I NDIKIMIT MJEDISOR	30	211	31		180	15%	1	103%
38	APLIKIMI I ARM	390	600	200	50	400	33%	(190)	51%
39	PAGESA E KRYEPLEQVE TE FSHATIT	829	3,119	2,362	709	757	76%	1,533	285%
40	SHPENZIME TRANSPORTI	41	82			82	0%	(41)	0%
41	DRU ZJARRI	1,052	3	3		-	100%	(1,049)	0%
42	QERA AMBJENTI	17				-	#DIV/0!	(17)	0%
43	FESTA E ZONES LEKAS	185	230	190		40	83%	5	103%
	TOTAL SHPENZIME OPERATIVE	42,599	61,509	51,130	4,420	10,379	83%	8,531	120%
	Projekte	3,641	6,995	4,539	911	2,456	65%	898	125%
44	SHER TE PRINTIMIT DHE PUBLIKIMIT	362	1,128	283	654	845	25%	(79)	78%
45	SHPENZIME PRITJE PERCJELLJE		90	77		13	86%	77	#DIV/0!
46	SHPENZIME QERAMARRJE AMBIENTI	1,504	2,837	1,830	152	1,007	65%	326	122%
47	SHPENZIME QERAMARRJE TE TJERA	947	100	108		(8)	108%	(839)	11%
48	SHPENZIME QERAMARRJE APARATE DHE PAISJE	120	1,025	954		71	93%	834	795%
49	SHPENZIME TRANSPORTI	175	40	30		10	75%	(145)	17%
50	SHPENZIME TE TJERA		33	13		20	39%	13	#DIV/0!
51	SHPENZIME HONORARE	533	440	424		16	96%	(109)	80%
52	SHPENZIME ENERGJI DHE UJE		1,302	820	105	482	63%	820	#DIV/0!
	TOTALI SHPENZIME OPERATIVE+PROJEKTE A	46,240	68,504	55,669	5,331	12,835	81%	9,429	120%
	Detyrimet nga fondi tranzitor	Fakt 2015	Pl 2016	Fakt 12m 2016	Det 2016	Dif Pl16-F16	%	Dif F16-F15	%
1	Shërbim interneti		97			97	0%	-	#DIV/0!

RAPORT FINANCIAR 2016

BASHKIA KORÇË

2	Raport VNM përroi Voskop, shk 9 vj Dërsnik		48	48		-	100%	48	#DIV/0!
3	Shtypshkrime		22			22	0%	-	#DIV/0!
4	Blerje klor		17	17		-	100%	17	#DIV/0!
5	Materiale për mirembajtje automjetet		85			85	0%	-	#DIV/0!
6	Pjesë kembimi automjetet		116	116		-	100%	116	#DIV/0!
7	Mirëmbajtje automjeti		98	98		-	100%	98	#DIV/0!
8	Blerje cemento		100	100		-	100%	100	#DIV/0!
9	Ftesa		31			31	0%	-	#DIV/0!
10	Printime		5	5		-	100%	5	#DIV/0!
11	Mjete pune		14	14		-	100%	14	#DIV/0!
12	Bojra		5	5		-	100%	5	#DIV/0!
13	VNM sistemim përroi		60	60		-	100%	60	#DIV/0!
14	Këshilltarët		768	723		45	94%	723	#DIV/0!
15	Detyrime në tatimet		592			592	0%	-	#DIV/0!
16	Zënie tregu		12			12	0%	-	#DIV/0!
17	Blerje karburanti		1,565	1,565		-	100%	1,565	#DIV/0!
	Total NJ.A. Voskop		3,635	2,751	-	884	76%	2,751	#DIV/0!
18	Shpenzime mirëmbajtje kompjuteri		37	37		-	100%	37	#DIV/0!
19	Shërbime postare		1	1		-	100%	1	#DIV/0!
20	SHA ujësjelles fshat shkolla Lumalas		1	1		-	100%	1	#DIV/0!
21	Fature uji Maj 2015		56	56		-	100%	56	#DIV/0!
	Total NJ.A. Bulgarec		95	95	-	-	100%	95	#DIV/0!
22	Qera për shkollën		15	15		-	100%	15	#DIV/0!
23	Vendime gjyqësore		560	514		46	92%	514	#DIV/0!
24	Shpenzime dru zjarri		138			138	0%	-	#DIV/0!
25	Shpenzime transporti		168	168		-	100%	168	#DIV/0!
	Total NJ.A. Lekas		881	697	-	184	79%	697	#DIV/0!
26	Aplikim prane ZRPP		259			259	0%	-	#DIV/0!
27	Shp telefonike Plus Communication		22	22		-	100%	22	#DIV/0!
	Total NJ.A. Drenovë		281	22	-	259	8%	22	#DIV/0!
	TOTAL B		4,892	3,565	-	1,327	73%	3,565	#DIV/0!
	TOTAL A+B	46,240	73,396	59,234	5,331	14,162	81%	12,994	128%

✓ **Huamarrja vendore (kredia)**

Në buxhetin e vitit 2016 është shlyer kredia e financuar nga Ministria e Financave, Pro Credit Bank, Intesa San Paolo.

Realizimi i kredisë për vitin 2016 jepet si më poshtë:

	PI 2016	Fakt 2016
SHLYERJA E KREDISË 2016	54,318	53,044
INTERESI	13,900	12,657
PAGESË PRINCIPALI	40,418	40,386

Shlyerja e kredisë sipas bankave deri në fund të vitit 2016 jepet si më poshtë:

ProCredit Bank

Për vitin 2010 shuma e disbursuar është 45.000.000 lekë.

Për vitin 2011 shuma e disbursuar është 23.800.000 lekë.

Për vitin 2012 shuma e disbursuar është 23.800.000 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin **e parë** të kredisë është: principali në vlerën 45.000.000 lekë dhe interesi në vlerën 18,216,783.67 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Tetor 2010- Dhjetor 2016 janë paguar principal në vlerën 24,132,466.13 lekë dhe interes në vlerën 16,513,774.31 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin **e dytë** të kredisë është: principali në vlerën 23.800.000 lekë dhe interesi në vlerën 8,991,566.21 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim Qershor 2011- Dhjetor 2016 janë paguar principal në vlerën 11,577,754.00 lekë dhe interes në vlerën 7,846,044.50 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin **e tretë** të kredisë është: principali në vlerën 23.800.000 lekë dhe interesi në vlerën 7,997,090.56 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim Tetor 2012- Dhjetor 2016 janë paguar principal në vlerën 8,179,301.87 lekë dhe interes në vlerën 6,060,644.43 lekë.

Intesa SanPaolo Bank

Për vitin 2014 shuma e disbursuar në muajin Tetor është 49,000,000 lekë , në muajin Dhjetor është 100,000,000 lekë dhe në fund të muajit Mars 2015 është 50,000,000 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin **e parë** të kredisë është: principali në vlerën 50,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 15,821,710.56 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Shkurt 2015- Dhjetor 2016 janë paguar interes në vlerën 5,310,554.82 lekë dhe principal 4,463,339.72 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin **e dytë** të kredisë është: principali në vlerën 100,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 28,678,919.58 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Shkurt 2015- Dhjetor 2016 janë paguar interes në vlerën 10,079,487.98 lekë dhe principal 9,138,910.58 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e **tretë** të kredisë është: principali në vlerën 50,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 16,203,793.05 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Mars 2015- Dhjetor 2016 janë paguar interes në vlerën 4,814,387.02 lekë dhe principal 3,397,826.42 lekë.

CEB

Në bazë të marrëveshjes të nën-huasë së nënshkruar midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bashkisë Korçë datë 13.02.2008, me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.37 datë 13.06.2007 mbi projektin “Ndërtimin e Banesave me Qëllim Social”, i përcaktuar në Marrëveshjen e kredisë lidhur në Gusht 2007 ndërmjet Këshillit të Ministrave si përfaqësues i Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB).

Transhi I 2014-2023 shuma e disbursuar është 340,214 euro

Transhi II 2016-2025 shuma e disbursuar është 640,000 euro

Transhi III 2017-2026 shuma e disbursuar është 110,000 euro

Transhi IV 2018-2027 shuma e disbursuar është 101,386 euro

Sipas planit të pagesave të transhit të parë për periudhën Dhjetor 2014-Dhjetor 2016 janë paguar principal në vlerën 14,206,448 lekë.

Sipas planit të pagesave të transhit të dytë për periudhën Shtator 2016-Dhjetor 2016 janë paguar principal në vlerën 8,985,600 lekë.

✓ Transferta tek organizatat

Fondi i planifikuar për transfertat tek organizatat e ndryshme për vitin 2016 ka qënë në vlerën 38,855 mijë

Realizimi i transfertës në total për vitin 2016 ka qënë 37,020 mijë lekë ose 95% të paraqitura si më poshtë:

000/lekë									
	TRANSFERTA TEK ORGANIZATAT	Fakt 2015	Pl 2016	Fakt 12m 2016	Det 2016	Dif Pl16-F16	%	Dif F16-F15	%
1	AGJENTI TATIMOR ALBEN 2 SECURITY	7,370	10,065	9,464	614	601	94%	2,094	128%
2	TRANSFERTE PER UKK KORCE	5,000	5,000	5,000		-	100%	-	100%
3	KONTRIBUT I BASHKISE PER KRWM	2,000	4,000	4,000		-	100%	2,000	200%
4	TRANSFERTA PER SHOQATEN BID	489	2,200	2,116		84	96%	1,627	433%
5	KONTRIBUTI PER UJESJELLES FSHAT PER ENERGIJE		229	229		-	100%	229	#DIV/0!
6	TATIM TAKSA DETYRIME NDAJ SHITETIT		1	1		-	100%	1	#DIV/0!
7	KONTRIBUT I BASHKISE PER AEROPORT		700			700	0%	-	#DIV/0!
8	KOMISION PER TATIMIN E THJESHTUAR TE BIZNESIT TE VOGEL	586	409	116	6	293	28%	(470)	20%
9	KONTRIBUTI PER SHOQATEN E BASHKIVE		1,290	1,290		-	100%	1,290	#DIV/0!

10	KONTRIBUTI FINANCIAR PER REALIZIMIN E PROJEKTIT PUNIME PER IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT TE SHETITORES FAN NOLI DHE KOMPLETIMI I SISTEMIT TE NDRICIMIT TE UNAZES SE QYTETIT		14,089	14,089		-	100%	14,089	#DIV/0!
11	KTHIM PAGESE PER ITSGA SHA		72			72	0%	-	#DIV/0!
12	KONTRIBUTI FINANCIAR I BASHKISE PER PAGESEN E TVSH	2,172	800	715		85	89%	(1,457)	33%
	Total	17,617	38,855	37,020	620	1,835	95%	19,403	210%

✓ Transferta tek individët

Fondi i planifikuar për transfertat tek individët ka qënë në vlerën 4,122 mijë lekë dhe realizimi shkoi në vlerën 187 mijë lekë ose 5% dhe konkretisht:

000/lekë

	TRANSFERTA TEK INDIVIDET	Fakt 2015	Pl 2016	Fakt 12m 2016	Dif Pl16-F16	%	Dif F16-F15	%
1	TRANSFERTA TEK INDIVIDET	279	118	77	41	65%	(202)	28%
2	TRANSFERTA NE RAST FATKEQESIE	130	190	100	90	53%	(30)	77%
3	TRANSFERTA TEK INDIVIDET PER SUBJEKTIN BULJANA MINCE		10	10	-	100%	10	#DIV/0!
4	NDIHME FIN PER FAMILJET NE NEVOJE		1,404		1,404	0%	-	#DIV/0!
5	PAGESA PER QYTETARIN V.TOMORI	15			-	#DIV/0!	(15)	0%
6	PAGESA PER QYTETARIN A.MILO	12			-	#DIV/0!	(12)	0%
7	BONUS STREHIMI PER QYTETARET		2,400		2,400	0%	-	#DIV/0!
	Total	436	4,122	187	3,935	5%	(249)	43%

✓ Fondi i emergjencave civile

Fondi i planifikuar për emergjencat civile për vitin 2016 ka qënë në vlerën 2,000 mijë lekë Ky fond u realizua në vlerën 1,943 mijë lekë ose 97%. Ndhimë financiare kanë përfituar familjet e dëmtuara nga zjarri si më poshtë:

Familja e A. Stratit, P. Begolli, A.Xhelillari	343,000 lekë
Familja e F. Kovaçi	200,000 lekë
Familja e K.Kreka	120,000 lekë
Familja e C. Tahirllari	300,000 lekë
Familja e V.Vangjel, Th. Jovan, K.Tahirllari	640,000 lekë
Familja e F. Kumani	200,000 lekë
Familja e A. Feko	140,000 lekë

✓ Këshilltarët

Planifikimi për pagesën e këshilltarëve gjatë vitit 2016 ka qënë në vlerën 6,581 mijë lekë dhe realizimi ka qënë në të njëjtën vlerë.

✓ Kontributi i Qarkut

Kontributi i Bashkisë Korçë për vitin 2016 ka qënë në vlerën 2,100 mijë lekë.

✓ SHËRBIMET PUBLIKE

1. **Shërbimi i transportit qytetës** gjatë vitit 2016 u planifikua dhe u realizua në po të njëjtën vlerë 7,000 mijë lekë. Ky shërbim jepet në formë subvencioni dhe mbështetet në realizimin e zërave të mëposhtëm :

- a. Itenerari i përcaktuar në kontratë i mjeteve.
- b. Orari i shërbimit të këtij transporti.
- c. Numri i mjeteve në linjë.
- d. Fluksi i kalimit të autobusëve nëpër stacionet e përcaktuara.
- e. Qëndrimi i mjeteve nëpër stacionet e përcaktuara.

2. **Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe ato të dëshmorëve**

Fondi i planifikuar për vitin 2016 ka qënë 4,087 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 3,912 mijë lekë ose në masën 95.7%. Ky shërbim konsiston në zërat e mëposhtëm:

- a. Pastrim parcelash, rrugë dhe sheshe të brendshme ndërmjet blloqeve të varrimit
- b. Mirëmbajtje drurë dhe shkurre dekorative.
- c. Mbjellje drurë dekorative.
- d. Mirëmbajtje dhe krijim gardhe të gjelbërt me ligustër dhe lavandinë.
- e. Kositje, grumbullim dhe transport bari.
- f. Mirëmbajtje bordure betoni të brendshme.
- g. Lyerje me gëlqere të bordurave dhe pemëve në varrezat publike dhe të dëshmorëve.
- h. Ruajtja e objektit në varrezat publike dhe të dëshmorëve.
- i. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve.
- j. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve nga amortizimi.
- k. Mirëmbajtje e murit rrethues.
- l. Konsumi i ujit të pijshëm për mirembajtje dhe nevojat e qytetarëve.

3. **Shërbimi i pastrimit të qytetit**

Fondi i planifikuar për vitin 2016 ka qënë 82,447 mijë lekë nga të cilat 23,545 mijë lekë ishin detyrim i vitit 2015 dhe 58,902 mijë lekë fondi i planifikuar në vitin 2016 dhe realizimi ka qënë në vlerën 78,805 mijë lekë ose në masën 95.5%.

Objekti i këtij shërbimi është:

- pastrimi i rrugëve dhe trotuareve,
- evadimi i mbetjeve urbane në qytetin e Korçës dhe përpunimi i tyre,
- lagia e rrugëve,
- evadimi i dëborës në stinën e dimrit dhe hedhja e kripës për lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe njerëzve, etj.

Pastrimi i rrugëve bëhet çdo ditë prej orës 24.00 deri 06.00. Pastrohen çdo ditë 429,861 m² rrugë dhe trotuare. Transporti i mbeturinave për në fushën e grumbullimit dhe përpunimit të tyre bëhet çdo ditë me mjete teknologjike prej orës 03.00 deri 07.00 për evadimin e mbetjeve nëpër konteniere dhe prej orës 07.00 deri 11.00 për lagjet që nuk kanë konteniere. Çdo ditë evadohen rreth 80 ton mbeturina. Lagia e rrugëve bëhet për periudhën 01.04 deri 31.10 çdo ditë nga ora 06.00 deri 18.00 në një sipërfaqe prej 295,870 m² si dhe larje speciale e rrugëve me sipërfaqe 70,236 m² çdo ditë. Grumbullimi i mbeturinave bëhet me rreth 400 konteniere.

Gjithashtu në këtë shërbim hyn edhe pagesa për supervizorin e pastrimit. Fondi i planifikuar për shpenzime për paga për vitin 2016 ka qënë 576 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 489 mijë lekë ose 85%.

Fondi i planifikuar për shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2016 ka qënë 96 mijë lekë. dhe realizuar 82 mijë lekë ose në masën 85%.

TRANSFERTAT SPECIFIKE

Pjesë përbërëse e buxhetit të Bashkisë për vitin 2016 kanë qënë dhe funksionet e reja të financuara nga transfertat specifike si:

- Mbrojtja nga zjarri
- Administrimi i pyjeve

✓ Mbrojtja nga Zjarri

Fondi i planifikuar nga transfertat specifike për këtë shërbim ka qënë në vlerën 25,356 mijë lekë. Numëri i punonjësve për vitin 2016 për këtë shërbim ka qënë 31 punonjës.

-Fondi i planifikuar për paga ka qënë në vlerën 19,538 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 19,531 mijë lekë ose në masën 100%.

-Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore ka qënë në vlerën 3,295 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 3,262 mijë lekë ose në masën 99%.

-Fondi i planifikuar për shpenzime operative ka qënë në vlerën 2,523 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 1,441 mijë lekë ose në masën 57%. Detajimi i shpenzimeve operative paraqitet si më poshtë:

MBROJTJA NGA ZJARRI

	Emertimi	Pl 2016	Fakt 12m 2016	Det 2016	Dif Pl16-F16	%	Dif F16-F15	%
1	Kancelari, materiale zyre	12			12	0%	-	#DIV/0!
2	Materiale pastrimi e ndriçimi	22	21		1	95%	21	#DIV/0!
3	Materiale ngrohje dhe dru zjarri	204			204	0%	-	#DIV/0!
4	Blerje dokumentacioni shtypshkrime	20	15		5	75%	15	#DIV/0!
5	Energji elektrike	370	356		14	96%	356	#DIV/0!
6	Shpenzime uji	165	131		34	79%	131	#DIV/0!
7	Shpenzime telefonike	20			20	0%	-	#DIV/0!
8	Shërbime postare	15			15	0%	-	#DIV/0!
9	Karburant	880	880		-	100%	880	#DIV/0!
10	Vaj filtra	30		25	30	0%	-	#DIV/0!
11	Pjesë këmbimi, ndërrim filtra	180		143	180	0%	-	#DIV/0!
12	Siguracion mjeteve transporti	216	32		184	15%	32	#DIV/0!
13	Shpenzime të tjera transporti	240			240	0%	-	#DIV/0!
14	Shërbime e dieta	25	6		19	24%	6	#DIV/0!
15	Shpenzime mirëmbajtje transporti	24			24	0%	-	#DIV/0!

16	Vendime gjyqësore	100			100	0%	-	#DIV/0!
	Total Mbrojtja nga zjarri	2,523	1,441	168	1,082	57%	1,441	#DIV/0!

Fondet e papërdorura nga kjo transfertë specifike në vlerën 1,124 mijë lekë trashëgohen për vitin 2017 dhe përdoren përsëri për këtë funksion. Informacion më i detajuar jepet në materialin e paraqitur pranë Këshillit Bashkiak për përdorimin e të ardhurave të trashëguara.

Gjithashtu gjatë vitit 2016 janë krijuar të ardhura nga ky shërbim në vlerën 881 mijë lekë dhe do të përdoren gjatë vitit 2017.

✓ Administrimi i pyjeve

Fondi i planifikuar nga transfertat specifike për këtë shërbim ka qënë në vlerën 3,066 mijë lekë. Numëri i punonjësve për vitin 2016 për këtë shërbim ka qënë 5 punonjës.

-Fondi i planifikuar për paga ka qënë në vlerën 2,328 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 1,635 mijë lekë ose në masën 70%.

-Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore ka qënë në vlerën 389 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 273 mijë lekë ose në masën 70%.

-Fondi i planifikuar për shpenzime operative ka qënë në vlerën 349 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 204 mijë lekë ose në masën 58%. Detajimi i shpenzimeve operative paraqitet si më poshtë:

	Emertimi	PI 2016	Fakt 12m 2016	Det 2016	Dif PI16-F16	%	Dif F16-F15	%
1	Kancelari, materiale zyre				-	#DIV/0!	-	#DIV/0!
2	Materiale pastrimi e ndriçimi				-	#DIV/0!	-	#DIV/0!
3	Materiale ngrohje dhe dru zjarri				-	#DIV/0!	-	#DIV/0!
4	Dieta	50	19		31	38%	19	#DIV/0!
5	Bloqe adm (vertetim te transo per levizjen e lendes drusore)	185	185		-	100%	185	#DIV/0!
6	Karburant	114			114	0%	-	#DIV/0!
	Total Administrimi i pyjeve	349	204		145	58%	204	#DIV/0!

Fondet e papërdorura nga kjo transfertë specifike në vlerën 957 mijë lekë trashëgohen për vitin 2017 dhe përdoren përsëri për këtë funksion. Informacion më i detajuar jepet në materialin e paraqitur pranë Këshillit Bashkiak për përdorimin e të ardhurave të trashëguara.

Gjithashtu gjatë vitit 2016 janë krijuar të ardhura nga ky shërbim në vlerën 11,633 mijë lekë nga të cilat 9,306 mijë lekësh u përdorën për investime dhe vlera prej 2,327 mijë lekësh do të përdoret gjatë vitit 2017.

Bordi i Kullimit

Për vitin 2016 për funksionin e bordit të kullimit është paguar nga ana e Bashkisë deri në momentin e transferimit të këtij funksioni tek Ndërmarrja e Shërbimeve Publike pagesa për paga dhe sigurime shoqërore si më poshtë:

Pagesa për paga në vlerën 772 mijë lekë dhe sigurime shoqërore në vlerën 130 mijë lekë.

Bordi i Kullimit	PI 2016	F 2016	%
Shp personeli	972	972	100%

✓ ANALIZA E PROJEKTEVE PËR VITIN 2016**Festa e Birrës 2016**www.festaebirres.comwww.korcabeerfest.com**Përshkrim shkurtimisht:**

Projekti “Festa e Birrës”, i implementuar për të dhjetin vit radhazi duke pasur gjithmonë si qëllim stimulimin, mbështetjen dhe promovimin e bizneseve lokale, duke influencuar fort në zhvillimin e turizmit në qytet duke e kthyer në një pol të rëndësishëm turistik.

Risi e këtij viti ishte se festa u zgjerua edhe në Pazarin e Vjetër të Korçës duke ofruar serenata korcare dhe gatime tradicionale gjatë gjithë ditës, për të kaluar me pas tek sheshi ne krah të Stadiumit “Skënderbeu”. Gjatë pesë netëve të festës 10-14 Gusht 2016, u vu re një audience masive, jo vetëm nga qyteti i Korçës dhe rrethinat e tij, por edhe nga turistët vendas dhe të huaj, të ardhur posaçërisht për të qënë pjesë e këtij eventi të rëndësishëm.

Një vënd të rëndësishëm tek Festa e Birrës gjatë të pesta netëve zuri dhe show i festës, ku performuan kengëtare të fashmën shqiptare, si Alban Skënderaj, Flori Mumajesi, Juliana Pasha, Ashtu si çdo vit, festa përveçse dëshmoi 10 vjet histori suksesi pati një rekord pjesëmarrësish dhe për pesë netë me rradhë qyteti u shndërrua në destinacionin më të frekuentuar turistik. Për një dekadë radhazi, kjo festë, e cila tashmë identifikohet me Korçën dhe birrën e saj, kulmon sezonin turistik duke marrë vulën e organizimit më të madh veror në vend.

Vlera totale e këtij projekti nga Bashkia: **1 000 000 Lek**

Vlera e realizuar e projektit: **954 000 Lek**



Foto nga Festa e Birrës 2016

Festa e Lakrorit**Përshkrim shkurtimisht:**

Projekti “Festa e Lakrorit 2016” u implementua edhe këtë vit në formën e një eventi që tërhoqi vëmendjen dhe pjesëmarrjen e shumë vizitorëve, duke konsoliduar profilin festiv të kësaj tradite. Festa e Lakrorit këtë vit, u zhvillua në fshatin Polenë, ditën e shtunë në datë 23 Korrik 2016, me qëllim gjallërimin e jetës sociale kulturore si dhe nxitjen dhe zhvillimin ekonomik të zonës.

Në këtë festë një ditore morën pjesë amvisa nga fshati Polenë (qëllim ruajtjen e traditës kulinare të zonës) si dhe për herë të parë pjesëmarrëse në këtë aktivitet ishte dhe firma e miellit Atlas e cila përgatiste produkte brumi të gatuar në cast. Më tepër se 300 lakrorë u gatuan në cast dhe u poqën për të gjithë ata që kishin vendosur të shijonin një prej gatimeve më të veçanta korçare. Lëngje frutash apo dhe ëmbëlsira shoqëronin gatimet e përgatitura në cast.

Gjatë gjithë aktivitetit, nuk munguan edhe vallet tradicionale të zonës së Korçës si dhe karnavalet e famshme të Polenës apo dhe serenatat Korçare duke festuar deri në orët e vona të mbrëmjes. Pjesëmarrësit në këtë festë ishin të shumtë, rreth 1000 persona, nga të cilët shumica ishin qytetarë të Korçës që kishin ardhur në Polenë enkas për festë. Kjo festë është shndërruar tashmë në një traditë të përvitshme, që nuk sjell vetëm shije, por edhe argëtim për të gjithë qytetarët, si edhe vizitorët vendas dhe të huaj.

Bashkia e Korçës ishte organizatorja kryesore e festës duke pasur bashkëpunime të ngushta dhe me pleqësinë e fshatit, me amvisat si dhe me bizneset e tjera që u bënë pjesë e festës. Infrastruktura dhe mjetet e tjera të nevojshme për tu realizuar si festë u mundësuan nga buxheti i planifikuar.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **150 000 Lek**

Vlera e realizuar e projektit: **110 000 Lek**



Foto nga aktiviteti festa e lakrorit



Respekt për mësuesit

Përshkrim shkurtimisht:

Me rastin e 7-Marsit, festës së mësuesve, Bashkia Korçë zhvilloi ditën e hënë datë 7 Mars 2016, në ambientet e Grand Hotel një pritje koktej me mësues pensionistë korçarë, për të shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm në edukimin e brezave. Mësuesve të pranishëm në aktivitet, iu dhuruan lule në shenjë mirënjohjeje.

Në pritjen e nderit, Kryetari i Bashkisë përcolli urimet dhe falenderimet në emër të të gjithë brezave që këta mësues kanë edukuar për vite me rradhë për punën e tyre ndër vite, të cilët kanë punuar gjithë jetën në këtë profesion kaq të dashur duke edukuar me profesionalizëm, përkushtim dhe fisnikëri disa gjenerata. Në aktivitet ishin të ftuar edhe përfaqësues nga institucionet publike në qytet, të cilët përmes fjalës së tyre përshëndetëse uruan dhe përshëndetën mësuesit e pranishëm në aktivitet.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **200 000 Lek.**

Vlera e realizuar e projektit: **157 800 Lek**



Foto nga projekti "Respekt për mësuesit"

Panairi i Punës dhe Punësimi Sezonal

Përshkrim shkurtimisht:

Bashkia Korçë në kuadrin e programit "Qyteti mbështet të Rinjtë", në bashkëpunim me Universitetin "Fan S. Noli", Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Korçë, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (DRSHKP), Korçë dhe Inspektoriatin e Punës organizuan në datën 6 Qershor 2016, tek Pallati i Sportit "Tamara Nikolla", Korçë Panairin e Punës 2016. Ky projekt synon të ofrojë mundësi punësimi për të gjithë të rinjtë që kanë përfunduar arsimin e lartë dhe të mesëm, në biznese lokale, banka dhe institucione të tjera, të cilat ofrojnë vende të lira pune me kohë të plotë ose të pjesshme, duke shërbyer si një urë lidhëse dhe mundësi e njohjes së të rinjve me ofertat dhe kërkesat e tregut të punës. Ndryshe nga vitet e kaluara, këtë vit panairi ishte një panair rajonal, ku përveç institucioneve dhe bizneseve të Korçës, morën pjesë edhe punëdhënës nga Maliqi, Bilishti dhe Pogradeci, etj. Në të morën pjesë rreth 47 subjekte, të cilët kanë ofruar vende të lira pune, si dhe qindra aplikantë dhe të interesuar. Përzgjedhja e kandidatëve për vendet e lira të punës, u realizua përmes intervistimit të të rinjve nga institucionet, që morën pjesë në këtë projekt. Ky panair nga viti në vit sjell edhe më shumë rezultate duke identifikuar dhe ofruar mundësi orientimi dhe punësimi të reja. Gjithashtu u shërben punëdhënësve me mundësi konkrete për plotësimin e vendeve të lira të punës, duke e bërë këtë proces konkurrues, transparent dhe më të frytshëm. Bashkia e Korçës duke qënë pjesë e bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve Sociale dhe rinisë u paraqit në këtë panair prezantoi praktikën profesionale që do të zhvillohej në bashki. Gjithashtu bashkia mundësoi printimin e roll-up –eve identifikuese për cdo biznes pjesëmarrës.

Vlera totale e projektit: **100 000 Lek**

Vlera e realizuar e projektit: **43 200 Lek**



Foto nga Panairi i Punës 2016

Festa e Mollës

Përshkrim shkurtimisht:

Bashkia Korçë, në kuadër të programit “Korça, Shpirti i Traditës” me qëllim promovimin e produktit vendas (mollës) dhe gjallërimin e jetës kulturore dhe artistike të njësive administrative të Korçës organizoi në datën 2 Tetor 2016, në fshatin Dvoran të Korçës projektin Festa e Mollës.

Festa e mollës u zhvillua në dy faza. Faza e parë konsistonte në vjeljen e mollëve në ferma të fshatit Dvoran, me qëllim jo vetëm argëtimin por edhe njohjen me kulturën e mbjelljes të mollëve si dhe kujdesin për to. Faza e dytë konsistonte në organizimin e një panairi mollësh në qendër të fshatit (të llojeve të ndryshme) të prodhurara nga fermerët e zonës të Dvoranit të Korçës, si edhe nënproduktet e mollës si lëng mollë, liko, uthull molle etj. Këtu morën pjesë Shoqata e Prodhuesve të Mollës, Zvirinë, fermerë të Dvoranit si edhe disa prej fermerëve të Maqedonisë të cilët prezantuan mollët edhe nënproduktet e saj, me qëllim forcimin e bashkëpunimit me fermerët e Korçës. Atmosfera e festës u gjallërua edhe me muzikën dhe këngët tradicionale të zonës, të cilat u realizuan nga dy këngëtare të mirënjohura korçare Laxarela Deti dhe Androniki Petriti. Një vend i veçantë ju kushtua edhe fëmijëve nëpërmjet lojrave të organizuara nga QKF si dhe këndin e vizatimit të organizuar me pikturat e nxënësve të shkollës 9 vjeçare Dvoran. Aktiviteti vazhdoi deri në orët e pasdites duke ju dhënë mundësi të gjithë qytetarëve, por edhe vizitorëve vendas dhe të huaj të shijonin një fundjavë ndryshe në Korçë.

Bashkia e Korçës e realizoi këtë projekt me mbështetje të donatorëve si Agrinet si dhe mbuloi financiarisht pjesën artistike të aktivitetit.

Vlera totale e projektit: **70 000 Lek**

Vlera e realizuar e projektit: **60 752 Lek**



Foto nga “Festa e Mollës”

Korça Kult**Përshkrim shkurtimisht:**

Bashkia Korçë, me qëllim promovimin dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit të Korçës zhvilloi një sërë aktiviteteve kulturore në kuadër të projektit « Korça Kult », të cilat u zhvilluan në një hark kohor prej datës 29 Shtator 2016 deri në datën 3 Tetor 2016.

Gjatë kësaj periudhe u realizuan : 1. Koncerti i Korit “Lyra”, 2. Ekspozita fotografike « Sotir », 3. Mbrëmje poetike, dhe 4. Aktivitete sportive si më poshtë vijon:

